



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

**Memorandum Shpjegues për organizimin e dëgjimit publik për Buxhetimin
Gjinor dhe përfaqësuesit e OJQ-ve, të rinjve/rejave, pensionistëve/eve,
fermerëve/eve dhe përfaqësuesve të bizneseve të Komunës së Prizrenit për
hartimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2027 dhe Kornizës Afatmesme
Buxhetore (KAB) 2028–2029**

1. HYRJA:

Komuna e Prizrenit, në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, gjithëpërfshirjes dhe barazisë gjinore, organizon dëgjim publik të dedikuar për buxhetimin gjinor dhe përfshirjen e grupeve të ndryshme të interesit në procesin e planifikimit buxhetor për vitin 2027 dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2028–2029.

Ky dëgjim publik synon të krijojë një platformë gjithëpërfshirëse për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organizatave joqeveritare (OJQ), të rinjve dhe të rejave, pensionistëve/eve, fermerëve/eve dhe përfaqësuesve të bizneseve, me qëllim identifikimin e nevojave specifike gjinore, sociale dhe ekonomike në nivel lokal.

Përmes këtij procesi, Komuna e Prizrenit synon të sigurojë që planifikimi buxhetor të jetë i ndjeshëm ndaj gjinisë, të promovojë barazinë në shpërndarjen e burimeve publike dhe të adresojë në mënyrë të drejtë nevojat e të gjitha kategorive shoqërore.

2. BAZA LIGJORE:

Organizimi i dëgjimit publik mbështetet në legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, përkatësisht:

- Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;
- Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;
- Ligjin për Barazi Gjinore në Republikën e Kosovës;
- Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal;
- Statutin e Komunës së Prizrenit;
- Rregulloren Komunale për Transparencë;
- Qarkoren e Parë Buxhetore 2027/01 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për përgatitjen e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2027 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore 2028–2029;
- Aktet tjera nënligjore që rregullojnë procesin e planifikimit buxhetor, pjesëmarrjes qytetare dhe buxhetimit të ndjeshëm gjinor.

Këto dispozita obligojnë komunat që të sigurojnë pjesëmarrje të gjerë qytetare dhe integrim të perspektivës gjinore në proceset e planifikimit dhe shpërndarjes së burimeve publike.

3. PËRMBAJTJA:

Në kuadër të procesit të hartimit të Buxhetit të Komunës së Prizrenit për vitin 2027 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore 2028–2029, do të organizohet dëgjim publik i veçantë për buxhetimin gjinor dhe përfshirjen e grupeve të ndryshme shoqërore dhe ekonomike.

Qëllimi i këtij dëgjimi publik është të sigurojë që procesi buxhetor të reflektojë nevojat dhe prioritetet e grave dhe burrave në mënyrë të barabartë, si dhe të adresojë sfidat specifike të të rinjve/rejave, pensionistëve/eve, fermerëve/eve, organizatave të shoqërisë civile dhe sektorit të biznesit.

Në këtë dëgjim publik do të prezantohet Qarkorja e Parë Buxhetore e Ministrisë së Financave, e cila përcakton kornizën financiare për hartimin e Projekt-Buxhetit të Komunës së Prizrenit për vitin 2027. Sipas kësaj qarkoreje, buxheti i përgjithshëm i komunës për vitin 2027 është **79,118,941 euro**, i ndarë sipas kategorive ekonomike si vijon:

- **Paga dhe mëditje – 33,885,952 euro;**
- **Mallra dhe shërbime – 15,230,224 euro;**
- **Shpenzime komunale – 1,205,299 euro;**
- **Subvencione dhe transfere – 5,531,785 euro;**
- **Investime kapitale – 23,235,681 euro.**

Gjatë dëgjimit publik do të theksohet rëndësia e buxhetimit të ndjeshëm gjinor, si një qasje që siguron shpërndarje të drejtë të burimeve publike dhe adresim të pabarazive ekzistuese në shoqëri. Në këtë kuadër, pjesëmarrësit do të kenë mundësi të paraqesin propozime konkrete që lidhen me:

- fuqizimin ekonomik të grave dhe të rinjve;
- përmirësimin e shërbimeve sociale dhe mbështetjen për pensionistët;
- mbështetjen për bujqësinë dhe zhvillimin rural;
- përmirësimin e klimës së biznesit dhe mbështetjen për ndërmarrjet lokale;
- zhvillimin e programeve rinore, kulturore dhe sportive;
- rritjen e qasjes në shërbime publike të barabarta dhe gjithëpërfshirëse.

Të gjitha propozimet dhe rekomandimet e paraqitura gjatë dëgjimit publik do të evidentohen në procesverbal dhe do të analizohen nga Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, në bashkëpunim me drejtoritë relevante komunale. Vlerësimi i tyre do të bëhet në bazë të përputhshmërisë me prioritetet strategjike të komunës, kornizën ligjore në fuqi dhe mundësitë buxhetore të përcaktuara me Qarkoren Buxhetore.

Për të siguruar transparencë dhe pjesëmarrje të plotë, dokumentet përkatëse buxhetore do t'u vihen në dispozicion pjesëmarrësve dhe do të publikohen në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prizrenit dhe në platformat tjera të komunikimit publik.

4. PËRFUNDIMI:

Organizimi i dëgjimit publik për buxhetimin gjinor dhe përfshirjen e grupeve të ndryshme shoqërore dhe ekonomike përbën një hap të rëndësishëm drejt forcimit të demokracisë lokale, transparencës institucionale dhe barazisë në shpërndarjen e burimeve publike.

Ky proces kontribuon në ndërtimin e një buxheti më gjithëpërfshirës dhe më të drejtë, i cili pasqyron nevojat reale të qytetarëve të Komunës së Prizrenit, duke përfshirë gratë dhe burrat në mënyrë të barabartë, si dhe duke adresuar prioritetet e grupeve të ndryshme shoqërore dhe ekonomike.

Në përfundim, të gjitha rekomandimet e pranuar do të shqyrtohen me kujdes dhe, në përputhje me mundësitë financiare dhe dispozitat ligjore në fuqi, do të inkorporohen në Projekt-Buxhetin e Komunës për vitin 2027 dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore 2028–2029, duke reflektuar parimet e qeverisjes së mirë, barazisë gjinore dhe zhvillimit të qëndrueshëm.